




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister*

*Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance*

**RAPORTI VJETOR PËR KONSULTIMET ME PUBLIKUN PËR VITIN 2025**



**Mars 2026**

## Përmbajtja

### RAPORTI VJETOR PËR KONSULTIMET ME PUBLIKUN PËR VITIN 2025

1. Hyrje.....	5
2. Korniza institucionale dhe roli i (ZQM/ZKM).....	5-6
3. Metodologjia e raportimit.....	7
4. Pasqyra e përgjithshme e konsultimeve publike në nivel qendror për vitin 2025.....	7
5. Shpërndarja institucionale e dokumenteve në nivel qendror.....	14
6. Raportet finale të rrjedhës së procesit të konsultimit publik për dokumentet e publikuar.....	14-16
7. Pjesëmarrja e publikut dhe aktiviteti i bashkëpunëtorëve gjatë procesit të konsultimit publik.....	16-17
8. Numri dhe statusi i komenteve të raportuara në forma të tjera të konsultimit publik.....	16-18
9. Konsultimi publik në nivel lokal.....	19
10. Aktivitetet promovuese, përfshirja dhe qasja gjithëpërfshirëse.....	25
11. Përmirësimi dhe avancimi i procesit të konsultimeve me publikun, ngritja e kapacitetit të zyrtarëve dhe procesi i bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile .....	25-26
12. Sfidat e evidentuara.....	26
13. Rekomandimet.....	26-27
14. Përfundime.....	27-28
SHTOJCA I: Numri i përgjithshëm i projekt dokumenteve (Lista e dokumenteve të konsultuara gjatë vitit 2025).....	28-38
SHTOJCA II: Lista e dokumenteve të publikuara sipas regjistrimit të platformës prej 01.01.2025-31.12.2025 .....	39-49

### Lista e Tabelave

- Tabela 1: Përmbledhje e llojit të dokumenteve për konsultat e hapura gjatë periudhës- Data:01.01.2025-31.12.2025.
- Tabela 2: Numri i dokumenteve të konsultuara gjatë vitit 2025 për të cilat konsultimi është mbyllur-data 01.01.2025-31.12.2025 .
- Tabela3: Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas publikimit të raporteve finale Data: 01.01.2025-31.12.2025.
- Tabela4:Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas aktivitetit të bashkëpunëtorëve .
- Tabela 5: Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas institucioneve në nivel lokal - Konsultat që janë mbyllur gjatë periudhës 01.01.2025-31.12.2025
- Tabela 6: Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas publikimit të raporteve finale - Data: 01.01.2025-31.12.2025

### Lista e Figurave

- Figura 1.Përmbledhje e llojit të dokumenteve për konsultat gjatë periudhës - Data: 01.01.2025 - 31.12.2025
- Figura 2: Shkalla e plotësisimit të standardeve minimale për dokumentet e publikuara sipas institucioneve për vitin 2025
- Figura 3: Shkalla e plotësisimit të standardeve minimale për dokumentet e publikuara sipas institucioneve për vitin 2025
- Figura 4.Përmbledhje e llojit të dokumenteve sipas publikimit të raporteve finale për institucione gjatë periudhës - Data: 01.01.2025 - 31.12.2025
- Figura 5.Përmbledhje e llojit të dokumenteve në nivel lokal të publikuara gjatë periudhës - Data: 01.01.2025 - 31.12.2025

## *Lista e shkurtesave*

1. ZKM Zyra e Kryeministrit
2. ZQM Zyra për Qeverisje të Mirë
3. MAPL Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
4. MASHT Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
5. MBPZHR Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
6. MD Ministria e Drejtësisë
7. MFPT Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
8. MM Ministria e Mbrojtjes
9. MINT Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
10. MKRS Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve
11. MPB Ministria e Punëve të Brendshme
12. MPJD Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
13. MSH Ministria e Shëndetësisë
14. MMPHI Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
15. ME Ministria e Ekonomisë
16. MZHR Ministria e Zhvillimit Rajonal
17. MKK Ministria për Kthimit dhe Komuniteteve
18. KE Komisioni Evropian

Të nderuar/a,

Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, gjatë vitit 2025, ka intensifikuar përpjekjet për ta shndërruar procesin e konsultimeve publike në një shtyllë kyçe të qeverisjes demokratike. Përfshirja aktive e qytetarëve, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë relevantë ka kontribuar në rritjen e transparencës, forcimin e llogaridhënies dhe ngritjen e cilësisë së vendimmarrjes publike.

Gjatë këtij viti është shënuar progres i rëndësishëm në rritjen e pjesëmarrjes dhe në avancimin e platformës digjitale për konsultime publike, duke e bërë atë një mjet funksional dhe gjithëpërfshirës për dialog të drejtpërdrejtë me qytetarët. Njëkohësisht, kemi investuar në ngritjen e kapaciteteve institucionale për të siguruar zbatim më të qëndrueshëm dhe efektiv të këtij procesi.

Në linjë me këtë angazhim, viti 2025 ka shënuar gjithashtu hapa konkretë në zbatimin e Rregullores (QRK) - Nr.17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, në kompletimin e bazës rregullative dhe në fuqizimin e mekanizmave koordinues, duke vendosur themele të forta për avancimin e mëtejshëm të platformës dhe për zbatim më konsekuent të standardeve të konsultimit publik.

Pavarësisht progresit, sfidat mbeten reale—nga mungesa e kapaciteteve në disa institucione deri te përfshirja jo e barabartë e grupeve të interesit. Prandaj, prioritet i qartë mbetet zgjerimi i këtij procesi në nivel lokal dhe garantimi i një pjesëmarrjeje më të gjerë, më të drejtë dhe përfaqësuese.

Angazhimi ynë është i palëkundur, të ndërtojmë një kulturë të qëndrueshme të dialogut, ku qytetarët nuk janë vetëm dëgjues, por bashkë krijues të politikave publike.

Me respekt,  
Habit Hajredini

# **RAPORTI VJETOR PËR KONSULTIMET ME PUBLIKUN PËR VITIN 2025**

## **1. Hyrje**

Gjatë vitit 2025, Republika e Kosovës ka vazhduar avancimin e praktikave të konsultimit publik, me theks të veçantë në rritjen e transparencës, përfshirjes së publikut dhe forcimin e pjesëmarrjes së organizatave të shoqërisë civile në proceset e hartimit të politikave dhe legjislacionit.

Platforma për Konsultime me Publikun [https://konsultimet.rks-gov.net/\\_index.php](https://konsultimet.rks-gov.net/_index.php) ka vazhduar të shërbejë si instrumenti kryesor institucional për publikimin e dokumenteve për konsultim, përfshirjen e qytetarëve dhe palëve të interesit, si dhe për raportimin e rezultateve të këtyre proceseve. Përmes saj është mundur një nivel më i lartë i transparencës dhe një qasje më e strukturuar në procesin e konsultimit publik.

Në këtë kuadër, Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit (ZQM/ZKM) ka ushtruar rolin e saj koordinues dhe monitorues në mbështetje të institucioneve publike, duke kontribuar në standardizimin e raportimit, në përmirësimin e cilësisë së të dhënave dhe në forcimin e llogaridhënies institucionale.

Raporti vjetor për konsultimet me publikun për vitin 2025 paraqet zhvillimet kryesore gjatë periudhës raportuese 01.01.2025 – 31.12.2025, duke u mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet, të dhënat e publikuara në platformë dhe pasqyrat statistikore të përfshira në këtë raport.

## **2. Korniza institucionale dhe roli i Zyrës për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit ( ZQM/ZKM)**

Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit, në përputhje me mandatin e saj institucional, ka vazhduar të koordinojë dhe monitorojë procesin e konsultimeve publike në nivel qendror dhe lokal. Ky rol është realizuar përmes:

- ofrimit të udhëzimeve dhe sqarimeve për institucionet publike;
- koordinimit me koordinatorët për konsultime publike në ministri dhe institucione të tjera;
- mbështetjes teknike për përdorimin dhe funksionalizimin e platformës;
- monitorimit të publikimit të dokumenteve dhe të raporteve finale;
- verifikimit dhe konsolidimit të të dhënave të raportuara nga institucionet.

Përmes këtij angazhimi, Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit (ZQM/ZKM) ka kontribuar në përmirësimin e standardeve të raportimit institucional, në rritjen e transparencës dhe në forcimin e mekanizmave të pjesëmarrjes publike në proceset e politikë bërjes dhe vendimmarrjes.

### **3. Metodologjia e raportimit**

Raporti është hartuar në bazë të:

- të dhënave të raportuara nga koordinatorët për konsultime publike në ministri dhe në Zyrën e Kryeministrit;
- të dhënave të publikuara në Platformën për Konsultime me Publikun;
- të dhënave të mbledhura nga aktivitetet institucionale të ZQM/ZKM;
- të dhënave shtesë të siguruara përmes komunikimit dhe koordinimit me institucionet përgjegjëse.

Në rastet kur ka pasur mospërputhje ndërmjet të dhënave të raportuara nga institucionet dhe të dhënave të publikuara në platformë, janë kërkuar sqarime plotësuese nga institucionet përkatëse. Për nevoja të këtij raporti, harmonizimi i të dhënave është bërë duke u mbështetur në tabelat statistikore të përfshira në raport.

Ky raport fokusohet kryesisht në paraqitjen sasiore të të dhënave, përkatësisht në numrin e dokumenteve të publikuara, llojin e tyre, statusin e raporteve finale, pjesëmarrjen e publikut dhe numrin e komenteve të raportuara.

### **4. Pasqyra e përgjithshme e konsultimeve publike në nivel qendror për vitin 2025**

Kjo përmbledhje paraqet një pasqyrë të konsultimeve publike në nivel qendror për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025, bazuar në të dhënat e platformës për konsultime publike dhe raportimet e koordinatorëve përkatës. Analiza fokusohet në numrin dhe llojin e dokumenteve të hapura dhe të mbyllura për konsultim, nivelin e publikimit të raporteve finale, si dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset konsultative. Qëllimi është të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme mbi trendet e konsultimeve publike në nivel qendror dhe të vlerësojë nivelin e transparencës dhe përfshirjes së palëve të interesit në proceset vendimmarrëse.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se gjatë periudhës raportuese është zhvilluar një numër i konsiderueshëm konsultimesh publike në nivel qendror, me fokus kryesor në aktet nënligjore dhe dokumentet rregullative. Megjithatë, mbeten sfida në rritjen e pjesëmarrjes së publikut përmes platformës për konsultime dhe në sigurimin e publikimit të plotë dhe në kohë të raporteve finale të konsultimit.

Sipas të dhënave të harmonizuara për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025, në nivel qendror rezultojnë:

- 104 dokumente të hapura për konsultim gjatë periudhës;
- 118 dokumente me konsultim të mbyllur gjatë periudhës.

Gjatë periudhës raportuese 01.01.2025 – 31.12.2025, bazuar në të dhënat dhe raportet e pranuar nga të gjitha ministritë dhe institucionet përkatëse si dhe të dhënave të publikuara në platformë është konstatuar se një numër institucionesh nuk kanë zhvilluar konsultime publike në kuadër të platformës së konsultimeve publike.

Në këtë drejtim: Ministria e Ekonomisë nuk ka pasur dokumente të publikuara në platformën e konsultimeve publike gjatë kësaj periudhe, Ministria e Zhvillimit Rajonal nuk ka zhvilluar procese

konsultimi publik përmes platformës përkatëse si dhe Zyra e Komisionerit për Gjuhët nuk ka pasur dokumente të përfshira në platformën e konsultimeve publike.

Gjetjet në raport janë bazuar në informacionet zyrtare të dorëzuara nga institucionet përkatëse dhe janë reflektuar në raportin përmbledhës vjetor.

Duhet të përmendet se Ministria e Drejtësisë ka raportuar se, pasi ka pasur telashe për kyçje në platformë, ka publikuar katër akte të cilat kanë përfunduar fazën e konsultimeve me publikun përmes ueb faqes së tyre, pra janë katër dokumente, të cilat janë:

- Projekt Udhëzimi Administrativ për Përdorimin e Sistemit Informativ Noterial, Qasjen Elektronike dhe Shfrytëzimin e Regjistrave Publikë, si dhe Shkëmbimin e Informatave me Institucionet e tjera dhe dokumentet e bashkëngjitura. Nga data 06.10.2025 - 24.10.2025 <https://md.rks-gov.net/publikimet/konsultime/>
- Projekt Udhëzim Administrativ MD- Nr. Xxx/2025 për Regjistrimin Elektronik të Testamenteve. Nga data 06.10.2025 - 24.10.2025 <https://md.rks-gov.net/publikimet/konsultime/>
- Projekt Udhëzim Administrativ për mirëmbajtjen, sigurinë dhe përdorimin e Sistemit Elektronik për menaxhimin e informacionit dhe nxjerrjen e raporteve publike. Nga data 06.10.2025 - 24.10.2025 <https://md.rks-gov.net/publikimet/konsultime/>
- Projekt Udhëzimin Administrativ për Kriteret dhe Afatet Kohore të hartimit të Raporteve dhe Mbikëqyrjes së Personave të liruar me kusht, <https://md.rks-gov.net/publikimet/konsultime/>

Këto të dhëna nuk kanë hyrë në statistikat e përgjithshme të këtij raporti.

#### **4.1. Dokumentet e hapura për konsultim gjatë periudhës 01.01.2025 – 31.12.2025**

Bazuar në raportimet e koordinatorëve për konsultimet me publikun, të dhënat e nxjerra nga platforma për konsultime dhe përmbledhjen e tyre gjatë periudhës raportuese 01.01.2025 – 31.12.2025, ky nënkapitull paraqet një pasqyrë të dokumenteve të hapura për konsultim në nivel qendror. Analiza synon të ofrojë një vlerësim të përgjithshëm mbi numrin, shpërndarjen dhe trendet e konsultimeve publike, duke reflektuar nivelin e transparencës dhe përfshirjes së publikut në proceset vendimmarrëse.

Gjatë periudhës raportuese 01.01.2025 – 31.12.2025 janë hapur gjithsej 104 dokumente për konsultim publik në nivel qendror.

Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas institucioneve - Konsultat e hapura gjate periudhes (qe jane hapur gjate periudhes) -										
Data: 01.01.2025-31.12.2025										
Institucioni / Tipi dokumentit	Koncept dokument	Draft ligj	Plan i veprimit	Draft rregullore	Udhëzim administrativ	Strategji	Program	Tjeter	Totali	Ne perqindje ne raport me te gjitha IRK-te
Zyra e Kryeministrit	1	1	0	0	1	1	1	0	5	4.81%
Ministria e Kultures Rinise dhe Sportit	0	0	0	9	0	1	0	3	13	12.50%
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapesinor dhe Infrastruktures	0	1	0	1	14	1	0	1	18	17.31%
Ministria e Industrise, Ndermarrjes dhe Tregtise	1	2	0	0	8	0	0	0	11	10.58%
Ministria e Admsitrimt të Pushtetit Lokal	0	0	1	1	0	0	0	0	2	1.92%
Ministria e Mbrojtjes	0	0	0	4	0	0	0	0	4	3.85%
Ministria e Financave, Punes dhe Transfereve	0	0	1	1	1	0	0	0	3	2.88%
Ministria e Shendetesise	0	0	0	0	8	0	0	1	9	8.65%
Ministria e Bujqesise Pylltarise dhe Zhvillimit Rural	0	4	0	0	18	0	0	0	22	21.15%
Ministria e Ekonomise	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Ministria e Drejtises	0	0	0	1	5	0	0	0	6	5.77%
Ministria per Kthim dhe Komunitete	0	0	0	1	0	0	0	0	1	0.96%
Ministria e Puneve te Brendshme	0	0	0	2	0	2	0	0	4	3.85%
Ministria e Arsimit, Shkences, Teknologjise dhe Inovacionit	1	0	0	0	4	0	0	0	5	4.81%
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diaspores	0	0	0	1	0	0	0	0	1	0.96%
Ministria e Zhvillimit Rajonal	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
<b>Totali</b>	<b>3</b>	<b>8</b>	<b>2</b>	<b>21</b>	<b>59</b>	<b>5</b>	<b>1</b>	<b>5</b>	<b>104</b>	
<b>Ne perqindje</b>	<b>2.88%</b>	<b>7.69%</b>	<b>1.92%</b>	<b>20.19%</b>	<b>56.73%</b>	<b>4.81%</b>	<b>0.96%</b>	<b>4.81%</b>		


Tabela 1: Përmbledhja e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas institucioneve - Konsultat e hapura gjate periudhës: 01.01.2025-31.12.2025

Sipas llojit të dokumenteve, struktura paraqitet si vijon:

- 3 koncept-dokumente;
- 8 draft-ligje;
- 2 plane veprimi;
- 21 draft-rregullore;
- 59 udhëzime administrative;
- 5 strategji;
- 1 program;
- 5 dokumente të tjera.

Nga këto të dhëna rezulton se udhëzimet administrative përbëjnë kategorinë më të madhe të dokumenteve të hapura për konsultim, me 56.73% të totalit, të pasuara nga draft-rregulloret me 20.19%. Kjo tregon se gjatë vitit 2025 procesi i konsultimeve publike në nivel qendror është përqendruar kryesisht në dokumente të natyrës së udhëzimeve administrative dhe rregulloreve.

Figura 1. Përmbledhje e llojit të dokumenteve për konsultat gjatë periudhës - Data: 01.01.2025 - 31.12.2025



## 2. Statistikat e dokumenteve te publikuara sipas institucioneve (qendrore)




Figura 2. Përmbledhje e dokumenteve për konsultat gjatë periudhës - Data: 01.01.2025 - 31.12.2025

### 4.2. Dokumentet e mbyllura për konsultim gjatë periudhës 01.01.2025 – 31.12.2025

Bazuar në raportimet e koordinatorëve për konsultim publik, të dhënat e nxjerra nga platforma përkatëse dhe përmbledhjen e tyre gjatë periudhës raportuese 01.01.2025 – 31.12.2025, ky nënkapitull paraqet një pasqyrë të dokumenteve të mbyllura për konsultim në nivel qendror. Analiza synon të ofrojë një vlerësim të përgjithshëm mbi përmbylljen e proceseve të konsultimit publik, duke reflektuar

nivelin e realizimit të tyre dhe menaxhimin e ciklit të konsultimeve. Gjatë periudhës raportuese 01.01.2025 – 31.12.2025 janë mbyllur gjithsej 118 konsultime në nivel qendror.

Permbledhje e llojeve te dokumenteve te publikuara sipas institucioneve - Konsultat e mbyllura gjate periudhes (qe jane mbyllur gjate periudhes) - Data: 01.01.2025-31.12.2025										
Institucioni / Tipi dokumentit	Koncept dokument	Draft ligj	Plan i veprimit	Draft rregullore	Udhëzim administrativ	Strategji	Program	Tjeter	Totali	Ne perqindje ne raport me te gjitha IRK-te
Zyra e Kryeministrit	1	1	0	0	1	0	1	0	4	3.39%
Ministria e Kultures Rinise dhe Sportit	0	0	0	10	0	1	0	3	14	11.86%
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapesinor dhe Infrastruktures	0	2	3	1	15	1	0	1	23	19.49%
Ministria e Industrise, Ndermarresise dhe Tregtise	2	2	0	0	8	0	0	0	12	10.17%
Ministria e Admnsitrimit të Pushtetit Lokal	0	0	1	1	0	0	0	0	2	1.69%
Ministria e Mbrojtjes	0	0	0	4	0	0	0	0	4	3.39%
Ministria e Financave, Punes dhe Transfereve	0	0	1	2	1	0	0	0	4	3.39%
Ministria e Shendetesise	0	0	0	0	9	0	0	1	10	8.47%
Ministria e Bujqesise Pylltarise dhe Zhvillimit Rural	1	4	0	0	19	0	0	0	24	20.34%
Ministria e Ekonomise	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Ministria e Drejtisesise	0	0	0	3	6	0	0	0	9	7.63%
Ministria per Kthim dhe Komunitete	0	0	0	1	0	0	0	0	1	0.85%
Ministria e Puneve te Brendshme	0	1	0	2	0	2	0	0	5	4.24%
Ministria e Arsimit, Shkences, Teknologjise dhe Inovacionit	1	0	0	0	4	0	0	0	5	4.24%
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diaspores	0	0	0	1	0	0	0	0	1	0.85%
Ministria e Zhvillimit Rajonal	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
<b>Totali</b>	<b>5</b>	<b>10</b>	<b>5</b>	<b>25</b>	<b>63</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>5</b>	<b>118</b>	
<b>Ne perqindje</b>	<b>4.24%</b>	<b>8.47%</b>	<b>4.24%</b>	<b>21.19%</b>	<b>53.39%</b>	<b>3.39%</b>	<b>0.85%</b>	<b>4.24%</b>		

Tabela 2. Përmbledhje e llojeve te dokumenteve te publikuara sipas institucioneve-Konsultat që janë mbyllur gjatë periudhës 01.01.2025-31.12.2025

## 2. Statistikat e dokumenteve te publikuara sipas institucioneve (qendrore)




Figura 3. Përmbledhje e dokumenteve për konsultat gjatë periudhës - Data: 01.01.2025 - 31.12.2025

Sipas llojit të dokumenteve, ato shpërndahen si vijon:

- 5 koncept-dokumente;
- 10 draft-ligje;
- 5 plane veprimi;
- 25 draft-rregullore;
- 63 udhëzime administrative;
- 4 strategji;
- 1 program;
- 5 dokumente të tjera.

Edhe te konsultat e mbyllura, udhëzimet administrative përbëjnë pjesën më të madhe, me 53.39% të totalit, ndërsa draft-rregulloret përbëjnë 21.19%. Kjo konfirmon se edhe në proceset e përmbyllura, fokusi institucional ka qenë kryesisht në udhëzime administrative dhe rregullore.

## **5. Shpërndarja institucionale e dokumenteve në nivel qendror**

Institucionet/Ministritë e Linjës sipas Tabelës 2, me numrin më të madh të dokumenteve me konsultim të mbyllur gjatë periudhës raportuese 01.01.2025 – 31.12.2025 janë:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – 24 dokumente ose 20.34%;
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës – 23 dokumente ose 19.49%;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – 14 dokumente ose 11.86%;
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – 12 dokumente ose 10.17%;
- Ministria e Shëndetësisë – 10 dokumente ose 8.47%;
- Ministria e Drejtësisë – 9 dokumente ose 7.63%.

Ndërsa, sipas Tabelës 1, institucionet me numrin më të madh të dokumenteve të hapura për konsultim gjatë periudhës janë:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – 22 dokumente ose 21.15%;
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës – 18 dokumente ose 17.31%;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – 13 dokumente ose 12.50%;
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – 11 dokumente ose 10.58%;
- Ministria e Shëndetësisë – 9 dokumente ose 8.65%.

Nga këto të dhëna vërehet se një numër i kufizuar institucioneesh kanë përqendruar pjesën më të madhe të publikimeve për konsultim publik gjatë vitit 2025, ndërsa disa institucione nuk kanë publikuar dokumente fare gjatë periudhës raportuese.

## **6. Raportet finale të rrjedhës së procesit të konsultimit publik për dokumentet e publikuara**

Sipas Tabelës 3, nga gjithsej 118 dokumente me konsultim të mbyllur në nivel qendror. Këto të dhëna tregojnë se shumica e dokumenteve të mbyllura gjatë vitit 2025 janë shoqëruar me raport final të konsultimit publik. Megjithatë, përqindja e dokumenteve pa raport final mbetet e konsiderueshme dhe tregon nevojën për përmirësim të mëtejshëm të zbatimit të obligimeve për përmbylljen e plotë të procesit të konsultimit publik.

Institucionet që, sipas tabelës, kanë përmbushur plotësisht obligimin për publikimin e raporteve finale për të gjitha dokumentet e mbyllura gjatë periudhës janë:

- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Zyra e Kryeministrit;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Nga ana tjetër, disa institucione rezultojnë me performancë më të ulët sa i përket publikimit të raporteve finale, çka kërkon angazhim më të madh në përmbushjen e plotë të standardeve procedurale të konsultimit publik.

Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas publikimit të raporteve finale - Data: 01.01.2025-31.12.2025				
Institucioni	Me raport final	Pa raport final	Totali	Ne përqindje me raportin (Me raport / Pa raport)
Ministria e Kulturës Rinise dhe Sportit	14	0	14	100.00%
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	13	10	23	56.52%
Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	10	14	24	41.67%
Ministria e Drejtësisë	9	0	9	100.00%
Ministria e Industrisë, Ndermarresise dhe Tregtisë	7	5	12	58.33%
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	5	0	5	100.00%
Zyra e Kryeministrit	4	0	4	100.00%
Ministria e Mbrojtjes	4	0	4	100.00%
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	2	0	2	100.00%
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	1	3	4	25.00%
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	0	1	1	0.00%
Ministria e Integritimit Evropian [deri me 03.06.2020]	0	0	0	0.00%
Ministria e Zhvillimit Rajonal	0	0	0	0.00%
Ministria e Punëve të Brendshme	0	5	5	0.00%
Ministria për Kthim dhe Komunitete	0	1	1	0.00%
Ministria e Ekonomisë	0	0	0	0.00%
Ministria e Shëndetësisë	0	10	10	0.00%
<b>Totali</b>	<b>69</b>	<b>49</b>	<b>118</b>	
<b>Ne përqindje</b>	<b>58.47%</b>	<b>41.53%</b>		

Tabela 3. Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas publikimit të raporteve finale nga data 01.01.2025-31.12.2025

## 1. Përqindja e konsultave publike për të cilat janë dhënë raportet finale (qendrore)




Figura 4. Përmbledhje e llojit të dokumenteve sipas publikimit të raporteve finale për institucione gjatë periudhës - Data: 01.01.2025 - 31.12.2025

- 69 dokumente janë publikuar me raport final, ose 58.47%;
- 49 dokumente janë publikuar pa raport final, ose 41.53%.

## **7. Pjesëmarrja e publikut dhe aktiviteti i bashkëpunëtorëve gjatë procesit të konsultimit publik**

Gjatë vitit 2025, përmes procesit të konsultimit publik janë përcjellë dhe publikuar në platformën përkatëse një sërë dokumentesh të politikave dhe akteve normative në nivel qendror, duke synuar përfshirjen e publikut dhe palëve të interesit në vendimmarrje. Kjo pjesë paraqet pasqyrën e pjesëmarrjes së publikut dhe aktivitetit të bashkëpunëtorëve gjatë kësaj periudhe. Sipas Tabelës 4, nga gjithsej 104 dokumente të hapura për konsultim gjatë periudhës në nivel qendror, janë vetëm 5 dokumente që kanë pasur komente nga bashkëpunëtorët, ose 4.81%, ndërsa 99 dokumente janë publikuar pa komente, ose 95.19%.

Kjo pasqyron një nivel të ulët të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në platformë, të paktën sipas të dhënave të regjistruara në këtë kategori raportimi. Institucionet ku është evidentuar pjesëmarrje me komente në këtë tabelë janë:

- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Përqindjet më të larta të dokumenteve me komente, sipas kësaj pasqyre, i kanë:

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – 33.33%;

- Ministria e Punëve të Brendshme – 25.00%;
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit – 20.00%.

<b>Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas aktivitetit të bashkëpunëtorëve</b>				
<b>Datë 01.01.2025-31.12.2025</b>				
<b>Institucioni</b>	<b>Me komente (kontribute nga bashkëpunëtorët)</b>	<b>Pa komente (kontribute nga bashkëpunëtorët)</b>	<b>Totali</b>	<b>Ne përqindje ne raportin (Me komente / Pa komente)</b>
Zyra e Kryeministrit	0	5	5	0.00%
Ministria e Kulturës Rinise dhe Sportit	1	12	13	7.69%
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	1	17	18	5.56%
Ministria e Industrisë, Ndermarresise dhe Tregtisë	0	11	11	0.00%
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	0	2	2	0.00%
Ministria e Mbrojtjes	0	4	4	0.00%
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	1	2	3	33.33%
Ministria e Shëndetësisë	0	9	9	0.00%
Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	0	22	22	0.00%
Ministria e Ekonomisë	0	0	0	0.00%
Ministria e Drejtësisë	0	6	6	0.00%
Ministria per Kthim dhe Komunitete	0	1	1	0.00%
Ministria e Punëve të Brendshme	1	3	4	25.00%
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	1	4	5	20.00%
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	0	1	1	0.00%
Ministria e Zhvillimit Rajonal	0	0	0	0.00%
<b>Totali</b>	<b>5</b>	<b>99</b>	<b>104</b>	
<b>Ne përqindje</b>	<b>4.81%</b>	<b>95.19%</b>		

Tabela 4. Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas aktivitetit të bashkëpunëtorëve nga data 01.01.2025-31.12.2025

Megjithatë, duhet theksuar se kjo pasqyrë nuk i përfshin domosdoshmërisht të gjitha komentet e dhëna edhe në forma të tjera jashtë regjistrimit standard në platformë.

### **8. Numri dhe statusi i komenteve të raportuara në forma të tjera të konsultimit publik**

Platforma nuk ka qenë mjeti i vetëm për komentimin dhe kontributin e publikut në dokumentet e publikuara. Gjatë vitit raportues janë përdorur edhe forma të tjera të konsultimit publik, përmes të cilave palët e interesit kanë dhënë kontribute dhe komente lidhur me dokumentet e hartuara. Këto kanë përfshirë komunikimin me shkrim, dokumentet e bashkëngjitura, takimet e punës dhe mekanizma të tjerë konsultativë. Sipas Tabelës 5, institucionet kanë raportuar gjithsej 517 komente të pranuar përmes formave të tjera të konsultimit, përfshirë komunikimin me shkrim, dokumentet e bashkëngjitura, takimet e punës dhe mekanizma të tjerë konsultativë.

Nga këto:

- 217 komente janë miratuar plotësisht;
- 67 komente janë miratuar pjesërisht;
- 233 komente janë refuzuar.

	<u>Numri total i komenteve</u>	<u>Numri i komenteve të miratuara plotësisht</u>	<u>Numri i komenteve të miratuara pjesërisht</u>	<u>Numri i komenteve të refuzuara</u>
<b>MBPZHR</b>	102	57	15	30
<b>MAPL</b>	41	10	4	27
<b>MASHT</b>	57	30	8	19
<b>MD</b>	140	58	25	57
<b>MINTI</b>	58	8	4	46
<b>MKRS</b>	63	22	8	33
<b>MSH</b>	52	30	3	19
<b>ZKM/Zyra për Integrim Evropian</b>	4	2	0	2
<b>Totali</b>	<b>517</b>	<b>217</b>	<b>67</b>	<b>233</b>
MM	Sipas raportit nuk kanë komente			
MMPHI	Sipas raportit nuk kanë komente			
MF	Sipas raportit nuk kanë komente			
MPJD	Sipas raportit nuk kanë komente			
Zyra për Planifikim Strategjik	Sipas raportit dokumenti është ende në proces			

Tabela 5. Numri i komenteve që janë dhënë në format tjera të raportuara sipas institucioneve përgjegjëse

Këto të dhëna tregojnë se, edhe pse komentet e regjistruara drejtpërdrejt në platformë paraqiten të ulëta sipas Tabelës 4, në praktikë procesi i konsultimeve ka gjeneruar një numër dukshëm më të madh kontributesh përmes kanaleve të tjera.

Institucionet me numrin më të madh të komenteve të raportuara janë:

- Ministria e Drejtësisë – 140 komente;
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – 102 komente;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – 63 komente;
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – 58 komente;
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit – 57 komente;
- Ministria e Shëndetësisë – 52 komente;
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – 41 komente.

Kjo dëshmon se pjesëmarrja e publikut dhe e organizatave të shoqërisë civile në konsultime publike ka qenë më e gjerë se sa mund të rezultojë vetëm nga të dhënat e regjistruara automatikisht në platformë.

Shkalla e plotësisht të standardeve për procesin e konsultimeve sipas Rregullores së punës së qeverisë Edhe këtë vit kualiteti i konsultimit, metodologjia e përdorur për hartimin e këtij raporti dhe burimet e alokuara nuk e lejojnë vlerësimin e plotësisht të standardeve në aspektin kualitativ. Megjithatë, sipas informacioneve të ofruara përmes raportimit dhe atyre të publikuara, ka shumë shembuj të mirë të ministrive që kanë publikuar dhe konsultuar dokumente në platformë gjatë vitit 2025 sipas standardeve të rregullores dhe përtej kësaj kornize.

Ministritë që i kanë plotësuar standardet plotësisht janë: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal.

## **9. Konsultimi publik në nivel lokal**

Përveç nivelit qendror, gjatë këtij raportimi janë nxjerrë statistika dhe të dhëna edhe për nivelin lokal, duke ofruar një pasqyrë më të plotë të zhvillimit të konsultimeve publike në tërësi. Zgjerimi i sistemit të konsultimeve publike në nivel lokal përbën një nga zhvillimet pozitive të viteve të fundit. Gjatë vitit 2025, përdorimi i platformës është shtrirë në shumicën e komunave, të cilat kanë publikuar dokumente për konsultim publik dhe kanë filluar të krijojnë praktika më të qëndrueshme të raportimit dhe përfshirjes së publikut. Ky përbën një progres të dukshëm në nivelin lokal sa i përket konsultimeve publike, megjithatë ende mbetet nevojë për monitorim më të vazhdueshëm dhe raportim të një cilësie më të lartë. Sipas Tabelës 6, gjatë periudhës 01.01.2025 – 31.12.2025, në nivel lokal janë mbyllur gjithsej 88 konsultime publike.

Sipas llojit të dokumenteve, ato përfshijnë:

- 5 koncept-dokumente;
- 13 plane veprimi;
- 17 draft-rregullore;
- 3 strategji;
- 50 dokumente të tjera.

Kategoria me pjesëmarrjen më të lartë në nivel lokal është kategoria “Tjetër”, me 56.82% të totalit, e ndjekur nga:

- draft-rregulloret me 19.32%;
- planet e veprimit me 14.77%.

Komunat me numrin më të madh të dokumenteve të mbyllura gjatë periudhës janë:

- Komuna e Prizrenit – 20 dokumente ose 22.73%;
- Komuna e Ferizajt – 10 dokumente ose 11.36%;
- Komuna e Gjilanit – 9 dokumente ose 10.23%;
- Komuna e Shtimes – 7 dokumente ose 7.95%;
- Komuna e Lipjanit – 6 dokumente ose 6.82%.



<b>Komuna Lipjan</b>	0	0	2	1	0	1	0	2	6	6.82%
<b>Komuna Malishevë</b>	1	0	0	0	0	0	0	1	2	2.27%
<b>Komuna Mamushë</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
<b>Komuna Mitrovicë</b>	0	0	1	1	0	0	0	3	5	5.68%
<b>Komuna Mitrovica Veriore</b>	0	0	0	0	0	0	0	1	1	1.14%
<b>Komuna Novobërdë</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
<b>Komuna Obiliq</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
<b>Komuna Partesh</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
<b>Komuna Pejë</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
<b>Komuna Podujevë</b>	0	0	1	1	0	0	0	0	2	2.27%
<b>Komuna Prishtinë</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
<b>Komuna Prizren</b>	0	0	2	3	0	1	0	14	20	22.73%
<b>Komuna Rahovec</b>	0	0	1	1	0	0	0	0	2	2.27%
<b>Komuna Ranillug</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
<b>Komuna Shtërpcë</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
<b>Komuna Shtime</b>	0	0	1	4	0	0	0	2	7	7.95%

<b>Komuna Skenderaj</b>	0	0	0	0	0	0	0	1	1	1.14%
<b>Komuna Suharekë</b>	0	0	2	1	0	0	0	2	5	5.68%
<b>Komuna Viti</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
<b>Komuna Vushtrri</b>	0	0	0	2	0	0	0	1	3	3.41%
<b>Komuna Zveçan</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
<b>Komuna Zubin Potok</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
<b>Totali</b>	5	0	13	17	0	3	0	50	88	
<b>Ne përqindje ne raport me te gjitha IRK-te</b>	5.68%	0.00%	14.77%	19.32%	0.00%	3.41%	0.00%	56.82%		



Këto të dhëna tregojnë se niveli lokal ka shënuar progres në përdorimin e platformës, megjithëse dallimet ndërmjet komunave mbeten të theksuara dhe kërkojnë mbështetje të mëtejshme për standardizim dhe përdorim më aktiv të mekanizmave të konsultimit publik.

#### **10. Aktivitetet promovuese, përfshirja dhe qasja gjithëpërfshirëse**

Gjatë vitit 2025, ZQM/ZKM ka vazhduar aktivitetet për promovimin e pjesëmarrjes publike dhe përdorimit të platformës për konsultime publike, me fokus të veçantë në përfshirjen e komuniteteve jo-shumicë dhe përmirësimin e qasjes për personat me aftësi të kufizuara.

Në bashkëpunim me partnerë institucionalë dhe organizata të shoqërisë civile, janë zhvilluar aktivitete informuese dhe promovuese me qëllim:

- rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e konsultimeve publike;
- nxitjen e përdorimit të platformës nga komunitetet jo-shumicë;
- promovimin e mos diskriminimit dhe gjithë përfshirjes;
- zgjerimin e qasjes në platformë për personat me aftësi të kufizuara.

Këto aktivitete kanë kontribuar në forcimin e përfshirjes qytetare dhe në promovimin e një qasjeje më të hapur dhe më gjithëpërfshirëse në proceset e politikë bërjes.

#### **11. Përmirësimi dhe avancimi i procesit të konsultimeve me publikun, ngritja e kapacitetit të zyrtarëve dhe procesi i bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile**

Përveç koordinimit të përditshëm dhe mbështetjes teknike, gjatë vitit 2025 është vazhduar edhe puna për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve publikë në fushën e konsultimeve publike.

Në këtë drejtim janë mbështetur:

- organizimi i trajnimeve për zyrtarët përgjegjës;
- promovimi i praktikave të mira të konsultimit;
- zhvillimi i qasjeve më të strukturuar për organizimin e proceseve konsultative;
- përdorimi i metodave të ndryshme të konsultimit, përfshirë konsultimet online, takimet fizike dhe komunikimin me shkrim.

Gjithashtu, ka vazhduar puna për hartimin e manualit për konsultime publike në përputhje me kornizën e re rregullative, me qëllim standardizimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të praktikës institucionale.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, për të përmirësuar dhe avancuar procesin e konsultimeve, ngritjen e kapaciteteve për zyrtarët, qasjen dhe koordinimin ndër-institucional për proces të konsultimit,

përveç punës së vazhdueshme është duke zbatuar dhe zhvilluar një sërë politikash dhe rekomandimesh që kanë rezultuar nga analizat dhe vlerësimet përkatëse të këtij procesi. Një nga dokumentet kyçe në këtë drejtim është “Korniza për përmirësimin e zbatimit të standardeve minimale për konsultimet me publikun për periudhën 2021–2025”, e cila është realizuar në bashkëpunim me OSBE-në. Aktualisht, po punohet në përmirësimin, zhvillimin dhe avancimin e funksionalitetit të përgjithshëm të Platformës Online për Konsultime me Publikun.

Në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të zyrtarëve publikë për procesin e konsultimeve, janë organizuar trajnime të ndryshme në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP), ekipin e trajnerëve të certifikuar dhe ZQM/ZKM dhe ekspert të tjerë. Këto trajnime janë mbajtur si në formë të grupeve, ashtu edhe brenda vetë institucioneve përgjegjëse për konsultime publike.

Po ashtu, është duke u përmirësuar qasja në Platformën Online për personat me aftësi të kufizuara, duke siguruar pjesëmarrje më të plotë dhe aktive të tyre në proceset shoqërore dhe në zhvillimin e politikave publike në Kosovë. Po përmirësohet

- Avancimi i përfshirjes së publikut dhe shoqërisë civile në konsultime po bëhet përmes qasjeve të strukturuar e të planifikuara mirë nga ana e institucioneve.
- Organizimi i trajnimeve të rregullta dhe të specializuara mbi pjesëmarrjen publike, teknikat e konsultimit dhe komunikimin me shoqërinë civile;
- Përdorimi e rasteve studimore dhe praktikave të mira nga vende të tjera;
- Hartimi i udhëzuesve praktikë, zhvillim i manualeve dhe protokolleve që udhëzojnë stafin për organizimin dhe menaxhimin efektiv të proceseve të konsultimeve;
- Përdorimi i metodologjive të ndryshme, si konsultimet online, takimet fizike, pyetësorët publikë, etj.
- Ekipet për ndarjen e përvojave dhe praktikave të mira, si dhe shkëmbime të drejtpërdrejta zyrtare për të mësuar nga modelet e suksesshme.

Një element kyç është edhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile (OSHC), përmes ndërtimit të kapaciteteve të përbashkëta dhe hartimit të proceseve të përbashkëta të konsultimit, duke nxitur partneritete efektive dhe të qëndrueshme.

## **12. Sfidat e evidentuara**

Pavarësisht progresit të arritur, gjatë vitit 2025 janë evidentuar disa sfida që vazhdojnë të ndikojnë në cilësinë dhe efektivitetin e procesit të konsultimeve publike.

Sfidat kryesore përfshijnë:

- nivelin e ulët të komenteve të regjistruara drejtpërdrejt në platformë;
- përfshirjen e kufizuar të një pjese të organizatave të shoqërisë civile, veçanërisht atyre jashtë rrjeteve të konsoliduara;
- cilësinë jo të njëjtë të raporteve finale ndërmjet institucioneve;
- mospërputhje të pjesshme ndërmjet të dhënave të raportuara dhe të dhënave të publikuara në platformë;
- mungesën e sqarimeve më të detajuara për komentet e refuzuara në disa raste;
- dallimet ndërmjet institucioneve dhe komunave sa i përket zbatimit të standardeve dhe raportimit.

Këto sfida tregojnë nevojën për përmirësim të mëtejshëm të cilësisë së raportimit, forcim të kapaciteteve institucionale dhe rritje të ndërveprimit me publikun dhe organizatat e shoqërisë civile.

### **13. Rekomandime**

Për përmirësimin e mëtejshëm të procesit të konsultimeve publike, rekomandohet:

- të hartohet dhe finalizohet manuali për konsultime publike në përputhje me Rregulloren e re të Punës së Qeverisë;
- të përmirësohet cilësia dhe plotësia e raporteve finale të konsultimit publik;
- të forcohet verifikimi dhe harmonizimi i të dhënave statistikore ndërmjet institucioneve dhe platformës;
- të rritet përdorimi efektiv i platformës për konsultime publike dhe regjistrimi më i plotë i komenteve të marra;
- të promovohet më gjerësisht platforma online për të nxitur pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile;
- të zgjatet periudha e konsultimeve për dokumente më komplekse dhe me ndikim më të gjerë publik;
- të forcohet komunikimi i dyanshëm me publikun për trajtimin e komenteve të pranuar, të pranuar pjesërisht dhe të refuzuara;
- të inkurajohet përfshirja e OSHC-ve lokale dhe e atyre që nuk janë pjesë e rrjeteve ekzistuese;
- të vazhdojë ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve publikë për organizimin dhe menaxhimin e proceseve të konsultimit publik;
- të zhvillohet më tej qasja gjithëpërfshirëse në platformë për komunitetet jo-shumicë dhe personat me aftësi të kufizuara.

### **14. Përfundime**

Gjatë vitit 2025, Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit ka vazhduar të luajë rol të rëndësishëm në avancimin e transparencës institucionale, në forcimin e konsultimeve publike dhe në përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike, qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile.

Të dhënat e harmonizuara të këtij raporti tregojnë se gjatë periudhës raportuese:

- në nivel qendror janë hapur 104 dokumente për konsultim publik;
- janë mbyllur 118 konsultime në nivel qendror;
- 69 dokumente janë shoqëruar me raport final;
- në nivel lokal janë mbyllur 88 konsultime publike;
- janë raportuar gjithsej 517 komente përmes formave të tjera të konsultimit.

Këto të dhëna dëshmojnë progres në funksionalizimin e sistemit të konsultimeve publike dhe në përdorimin e mekanizmave institucionale për përfshirjen e publikut. Megjithatë, ato tregojnë gjithashtu nevojën për përmirësim të mëtejshëm të cilësisë së raportimit, rritje të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në platformë dhe zbatim më të qëndrueshëm të standardeve për konsultime publike nga të gjitha institucionet.

Në këtë drejtim, vazhdimi i mbështetjes institucionale, forcimi i kapaciteteve profesionale dhe rritja e bashkëpunimit me shoqërinë civile mbeten thelbësore për zhvillimin e mëtejshëm të qeverisjes së hapur dhe të politikë bërjes gjithëpërfshirëse në Republikën e

Ky zhvillim reflekton përkushtimin në rritje të institucioneve publike për të zbatuar standardet demokratike dhe për të siguruar llogaridhënie në hartimin e politikave. Angazhimi i organizatave

joqeveritare dhe interesimi i tyre për të qenë pjesë aktive e procesit, si dhe raportimi më i qartë nga ana e institucioneve, janë tregues të një dinamike pozitive dhe progresive.

Platforma për Konsultimet Publike tashmë është një mjet institucional dhe zyrtar i domosdoshëm, që shërben si pikë qendrore e komunikimit ndërmjet institucioneve publike, palëve të interesuara dhe qytetarëve. Ajo siguron pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në procesin e politik bërjes dhe vendimmarrjes me interes publik, duke rritur transparencën dhe përgjegjësinë e organeve publike.

Pjesëmarrja aktive e shoqërisë civile është bërë gjithnjë e më e dukshme përmes kësaj platforme online, ku palët e interesuara janë regjistruar dhe kanë kontribuar përmes komenteve dhe pjesëmarrjes në hartimin e politikave dhe legjislacionit.

Në këtë drejtim, Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes Zyrës për Qeverisje të Mirë (ZQM) në Zyrën e Kryeministrit, ka shënuar progres në zhvillimin e standardeve dhe praktikave për rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në procesin e politikë bërjes. Një hap i rëndësishëm ka qenë integrimi i Rregullores për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimeve Publike (Nr. 05/2016) në Rregulloren e re të Qeverisë (Nr. 17/2024 për Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës).

Zyra për Qeverisje të Mirë, si koordinatore e procesit të konsultimeve publike, vazhdon të jetë përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha konsultimeve, përfshirë ato përmes platformës online. Aktualisht, kjo zyrë është në proces të inicimit dhe hartimit të një manuali të ri për zbatimin e Rregullores së re, ndërkohë që po vazhdohet të zbatohet manuali ekzistues deri në finalizimin e të riut. Në përputhje me Rregulloren e re të Punës së Qeverisë (Nr. 21.05.2025), Zyra për Qeverisje të Mirë, në bashkëpunim me koordinatorët për konsultime nga të gjitha ministritë dhe institucionet përkatëse, ka përgatitur edhe raportin vjetor të konsultimeve publike për vitin 2025.

Ky progres tregon për një angazhim të vazhdueshëm institucional për të forcuar dialogun me publikun dhe për të garantuar një proces më transparent dhe gjithëpërfshirës të politik bërjes në Republikën e Kosovës.

### **SHTOJCA I: Numri i përgjithshëm i projekt dokumenteve (Lista e dokumenteve të konsultuara gjatë vitit 2025)**

### **SHTOJCA II: Lista e dokumenteve të publikuara sipas regjistrimit të platformës prej 01.01.2025-31.12.2025**

	KONSULTAT	PLOTËSIMI I STANDARDEVE
<b>I.</b>	<b>ZYRA E KRYEMINISTRIT</b>	
	1. Programi Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2025-2029	PO
	2. Koncept dokument për Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës	PO
	3. PROJEKTLIGJI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NGA INSTITUCIONET E ZBATIMIT TË LIGJIT	PO
	4. PROJEKT UDHËZIM ADMINISTRATIV (IKKL) NR. XX/2025 PËR PROCEDURAT DHE MASAT PËR SHFRYTËZIMIN E MATERIALEVE TË ARKIVIT, SIGURINË E TË DHËNAVE PERSONALE APO TË DHËNAVE TË TJERA TË NDJESHME NË INSTITUTIN E KRIMEVE TË KRYERA GJATË LUFTËS NË KOSOVË	PO
	<b>MINISTRITË</b>	
<b>1.</b>	<b>MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL</b>	
	Kanë raportuar se nuk ka pasur dokumente për konsultim publik në platformë gjatë periudhës 01.01.2025 – 31.12.2025	
<b>2.</b>	<b>MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË</b>	
	5. UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASHTI) NR. ____/2024 PËR THEMELIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRAVE MËSIMORE	PO
	6. Udhëzim Administrativ Licencimi i bartësve privat te arsimit te lartë	PO
	7. UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASHTI) NR. ____/2025 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 18/2013 PËRDORIMI I PLANIT INDIVIDUAL TË ARSIMIT	PO
	8. UDHËZIM ADMINISTRATIV( MASHTI) NR. ____/2025 PËR KALENDARIN E VITIT SHKOLLOR 2025-2026	PO
	9. Koncept dokumenti për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale	PO

<b>3.</b>	<b>MFPT - MINISTERIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE</b>	
	10. RREGULLORE (QRK) – NR. XX/2024 PËR PROCEDURËN E REKRUTIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA	PO
